

## **STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT TE SHOQËRISË TREGTARE**

### **BIO FRESH FRUIT**

Në këtë statut:

- Ligji është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “;
- “Statuti “ është statuti i shoqërisë;
- 

#### **Kreu I**

##### **Themelimi, emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

##### **Neni 1**

##### **Data e themelimit, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

1. Sot më date 30.11.2022 une themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **BIO FRESH FRUIT**

2. Themelues I shoqerise

**Elton Laperi** i datelindjes 14.02.1977, i pajisur me id. H70214148E

##### **Neni 2**

##### **Objekti**

Shoqëria **BIO FRESH FRUIT** do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Tregti me pakice e me shumice fruta dhe perime. Import- eksport te frutave dhe perimeve. Shperndarje te mallrave te ndryshem industrial, ushqimore, veshmbathje etj. Transport i te gjitha llojeve te skrapit, import, eksport. Hapje bar- restorante, hoteleri, diskoteke dhe qendra estetike. Tregti me pakice te gjitha llojeve te karburanteve. Punime te montimit te rrjetave elektrike te prodhimit dhe te transmetimit te energjise, rrjetave elektrike te objekteve



industriale, radiovoni, citofoni, etj. Import eksport, tregtim i mallrave  
industrial dhe ushqimore me shumice dhe pakice si dhe prodhimi i tyre ne vend. Tregtim pije,  
konfeksione, hidrosanitare, tregtim pllaka shtrimi te llojeve te ndryshme  
hidraulike, bime medicinale, eterovajore, paisje elektrike, elektronike, elektrosh tepiake, Kinkaleri  
zyre e shkolllore, makineri, pjese kembimi per automjete, bateri, goma etj. Krijimi i serviseve per  
automjetet, lavazhe, tregtim vajrash si dhe sherbim per te gjitha llojet e makinave. Krijimi dhe  
hapja e agjensive turistike, agjenci informative etj. Transport i mallrave dhe pasagjereve Brenda  
dhe jashte vendit. Punime dheu, sistemime, tarracime, terrensh. Ndertime civile industriale  
turistike bujqesore etj, deri ne tete kate dhe 2 kompletim me instalimet e nevojshme. Ndertime  
rrugesh kategoria e peste dhe e gjashte. Ndertime vepra arti te vogla  
deri ne 6 metra. Ndertim ujsjellsash dhe kanalizimesh. Rikostruksione godinash civile  
ekonomike, veshje fasadash etj. Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit.  
Ndertime rrugesh dhe aeroportesh. Ndertime hekurudhore. Ndertime vepra arti rrugor dhe  
hekurudhor. Ndertime detare. Ndertime digash, rezervatesh. Ndertime hidroteknike. Vepra  
te vecanta dhe punime speciale. Punime restaurimi. Punime karpenterie. Punime montimi dhe  
teknologjike. Punime te montimit ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise, punime  
sherbimi te zakonshme te sistemit komuna dhe punime mirmbajtje. Punime topogjeodezike. Ne  
fushen e permirsimeve. Zbatimin e punimeve ne fushen e mbareshtimit te faunes e gjuetise  
sportive e turistike. Gjueti, sportive e turistike. Ne fushen e pyllezimeve. Zbatimin e punimeve.  
Ne fushen e mbarshtimit te flores spontane, mjeksore e tanifere. Grumbullimin e bimeve. ne  
fushen e mbrojtjes nga semundjet, demtuesit dhe zjarret. Import eksport te materialeve, mjeteteve  
dhe elementeve te sinjalistikes dhe sigurise rrugore. Prodhim, montim dhe shperndarja e  
materialeve dhe elementeve te sinjalistikes dhe sigurise rrugore. Blerje shitje marria e dhenia me  
qera e terreneve, ndertmeve, makinerive dhe paisjeve. Perfaqesime e konsulta teknike,  
ekonomike, financiare, juridike per llogari te te treteve. Te lidhe aktmarrveshje me shoqeri te  
tjera te vendit dhe te huaja. Transport Nderkombetar mallrash per te trete dhe me qera (per  
SH.A., Shpk., person fizik). Transport kombetar e nderkombetar mallrash per nevojat e veta te  
shoqerise. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez.

Çdo aktivitet tjeter tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e  
veprintarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### Neni 4



## Selia

Selia e shoqërisë eshte ne Kashar, Mezez, Autostrada Tirane – Durres, Km.1, Brenda ambjenteve te tregut Agroushqimor , Nr.Pasurie 52/8, ZK.2679

## Kreu II

## KAPITALI

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

1.Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 lekë i ndare ne 1 kuot.

#### **Elton Laperi zoterues 100 % I kuotave te kapitalit**

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtem

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të paluajtshme/të luajtshme apo të drejta).

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin themeltar;
- b) shitblerjes ;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

## Neni 8

### Organë Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblene e përgjithshme, nëbazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 % të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votive, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mijete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vundos me tri të katërtat e votive të zotëruar të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vundos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve;
  - e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave proçeduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë, Afati i emërit, është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundështim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënët e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat):

dhe specimenët e nënshkrimit:

**Elton Laperi** i datelindjes 14.02.1977, i pajisur me id. H70214148E

**Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesesë përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë qe lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

- Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikësrisë, sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” administrator detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arrijen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administrator vepron në kundështim me detyrat dhe shkel standartet professionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ështëi detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundështim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthehen ortakëve kontributet;
- b) u paguhen ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndahen aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti finanziar- ekspertët**

##### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti finanziar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

##### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kkontrollpjë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillëi ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të



ushtruara, të cilat ështëi detyruar që t’ia paraqesë e dorëzojë në kohëortakëve për t’i shqyrtuar miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## Kreu V

### Prishja – riorganizimi i shoqërisë

#### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “shoqëri në likujdim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19

##### Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### Neni 20

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tsaj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**


**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Sgoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**Elton Laperi**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Elton Laperi". Below the signature is a stylized, handwritten mark or initial.